



BASHKIA
TIRANË

URDHËR

Nr. 25341, datë 28.6.2017

“PËR MARRJEN E MASAVE TË MENJËHERSHME PËR KEQPËRDORIMIN E UJIT TË PIJSHËM DHE NDËRPRERJEN E LIDHJEVE E TË NDËRHYRJEVE TË BËRA PA LEJE NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat (b) dhe (c), nenit 23 dhe nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, vendimit nr. 1304, datë 11.12.2009 Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., në kuadër të marrjes së masave për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Tiranës, gjatë stinës së verës dhe monitorimin e situatës si pasojë e shpërdorimit apo ndërhyrjeve të bëra pa leje në rrjetin e ujësjellësit,

URDHËROJ:

1. Evidentimin e menjëhershëm dhe marrjen e masave ndaj çdo subjekti, juridik, fizik apo individ, që gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, tregtar apo privat, përdorë ujin e pijshëm në kundërshtim me kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë.
2. Për efekt të zbatimit të këtij urdhri, sipas parashikimeve të pikës 1 të tij, ndalohet kategorikisht përdorimi i ujit të pijshëm për lavazhe, ujitjen e tokës bujqësore, lagjen e trotuareve dhe rrugëve, mbushjen e pishinave, si dhe çdo lloj forme tjetër përdorimit të ujit të rrjetit të ujësjellësit në kundërshtim me parashikimet ligjore e nënligjore që normojnë këtë sektor.
3. Deri në muajin shtator 2017, uji i rrjetit të ujësjellësit destinohet vetëm për nevoja të përdorimit shtëpiak dhe atij sanitar, përfshirë këtu edhe shërbimet e higjienës publike në qytet.
4. Gjatë ushtrimit të kontrollit në terren dhe evidentimit të përdorimit të ujit të pijshëm në kundërshtim me kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë, veprohet nëpërmjet masave të menjëhershme të ndërprerjes së furnizimit me ujë dhe vendosjes së sanksioneve administrative.
5. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë urdhër dhe kuadrin rregullator të furnizimit me ujë, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
6. Çdo lidhje apo ndërhyrje tjetër e bërë pa leje në rrjetin e ujësjellësit, me qëllim marrjen e ujit të pijshëm dhe përdorimin e tij në kundërshtim me kuadrin rregullator, kur sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi përbën vepër penal, referohet në organet përkatëse ligj zbatuese.
7. Ngarkohet shoqëria Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë dhe Task – Forca e ngritur me urdhrin nr. 25049, datë 28.06.2017 të Kryetarit të Bashkisë “Për marrjen e masave për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Tiranës, gjatë stinës së verës dhe monitorimin e situatës si pasojë e shpërdorimit apo ndërhyrjeve të bëra pa leje në rrjetin e ujësjellësit”, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erion VELIAJ

